



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2023

Dt.26.01.2023

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 dhe 17 shkronja b të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 5 paragrafi 1.2 nën paragrafi 1.2.2 dhe nenin 10 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, neni 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 dhe nenit 20 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, dhe Udhëzimin Administrativ të MMPHI-së nr. 05/2014 për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikimin Hapësinor, nenin 4 paragrafi 3 pika 3.2 nenin 7 paragrafi 3, në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.01.2023 pas diskutimeve lidhur me pikën e 9 të rendit të ditës: Kërkesa për nxjerrjen e Vendimit për Hapjen e Shqyrtimit Publik të Projektit “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030”, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për

Shqyrtimin Publik të projektit “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030”

Neni 1

Me këtë vendim shpallet në shqyrtim publik projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030”.

Neni 2

2.1. Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030” bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës 8 (tetë) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2.2. Ekspozimi i projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030” bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës.

2.3. Shqyrtimi publik i projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030” zgjatë 30 (tridhjetë) ditë sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

2.4. Shpallja e shqyrtimit publik të projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030” bëhet 8 (tetë) ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, faqen zyrtare të komunës dhe në mediat televizive publike dhe lokale.

Neni 3

3.1 Në shqyrtimin Publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e Projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030”.

3.2 Projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030” është i qasshëm për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.

Neni 4

4.1 Projekt "Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030" i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të Publikut para se të finalizohet.

4.2 Të gjitha vërejtjet, Komentet dhe Sugjerimet që paraqiten nga Publiku me gojë gjatë diskutimeve, me shkrim në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin Publik.

Neni 5

Pas përfundimit të Projekt "Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030", drejtoria Për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit si autoritet përgjegjës për Planifikim hapësinor, do të kryej veprimet e parapara ligjore për Finalizimin e këtij dokumenti në mënyrë që ai ti prezantohet Kuvendit të Komunës për Shqyrtim dhe Miratim përfundimtar.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Gjakovës.

-Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.

Arbëneshë Kuqi
Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

